



KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 10.7.2019

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9636, DATË 6.11.2006, “PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT NGA PRODUKTET E DUHANIT”, TË NDRYSHUAR”

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, të ndryshuar”, në mbledhjen e datës 10 korrik 2019.

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin caktoi deputetin Andrea Marto relator për shqyrtimin e këtij projektligji.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve, ishin përfaqësues të ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale: znj. Mira Rakacolli, Zëvendesministre , znj. Antoneta Njehrrëna, Drejtor Juridik dhe znj. Vjollca Braho, Kryeinspektore e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, të ndryshuar””, është një nismë e Këshillit të Ministrave, e cila i paraqitet për shqyrtim Kuvendit, mbështetur në nenet 78, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit***

Qëllimi i ndryshimeve të propozuara nga projektligji është mbrojtja e shëndetit nga produktet e duhanit; rritja e monitorimit të duhanpirjes në Republikën e Shqipërisë, siguri i mbrojtjes së shëndetit të popullatës nga produktet e duhanit; forcimi i rolit monitorues të inspektoratit përgjegjës për shëndetësinë, në lidhje me zbatimin e ligjit për mbrojtjen e shëndetit nga duhani.

Ndryshimet që propozon projektligji konsistojnë në:

- Saktësimin e përkufizimeve të duhanit dhe nënprodukteve të tij si dhe përfshirja në këtë kategori e produkteve të reja të duhanit, me qëllim përfshirjen në kuadrin rregullator, të çdo produkti ose nënprodukti duhani që është i dëmshëm për shëndetin e popullatës, si dhe forcimin e kontrollit të duhanit dhe shmangies së rasteve abuzive.
- Detyrimin e tregtuesve për të informuar Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për hyrjen në treg të produkteve të reja të duhanit. Ky ndryshim synon të mbajë të informuar organet përkatëse për dinamikën e hyrjes së produkteve të reja në treg, karakteristikat e tyre dhe për efektet e mundshme pozitive apo negative që ata kanë në popullatë. Pasja e këtij informacioni pritet të mundësojë monitorim më të mirë të zbatimit të ligjit dhe të përshtatjes së tij në të ardhmen bazuar në produktet e reja që hyjnë në vend.
- Ndalimin e shitjes së paketave me numër të reduktuar cigaresh apo me alterim të shijeve mund të reduktojë blerjen e këtyre produkteve nga konsumatorë që nuk e përballojnë dot çmimin e një pakete të plotë apo nga konsumatorë për të cilët shija karakteristike e duhanit është një element i pakënaqshëm i duhanpirjes dhe në mungesë të shijeve alternative do zgjidhnin të mos konsumonin produktin konvencional.
- Ndalimin e promocionit të « fshehur » nëpërmjet ngjyrave të logos së produkteve të duhanit dhe vendosjen e tyre në raftet e dukshme, në kuadër të forcimit të kontrollit për moslejimin e promocionit dhe marketimit të produkteve të duhanit si një faktor që stimulon përdorimin e tij në popullatë.
- Ndalimin e përdorimit të cigares elektronike në ambiente të mbyllura duke aplikuar për të, të njëjtat rregulla si për format konvencionale të duhanpirjes, me synim mbrojtjen nga ekspozimi i pavullnetshëm ndaj produkteve të duhanit.
- Forcimin e masave ndëshkuese në rast moszbatimi të ligjit, me synim forcimin e implementimit të ligjit dhe shtimin e mbrojtjes për qytetarët që ekspozohen në mënyrë të pavullnetshëm ndaj tymit të duhanit, qoftë nga produkte konvencionale qoftë nga produkte inovative. Projektligji propozon shumëfishimin e masës së gjobës për subjektet e tatueshme që në mënyrë të përsëritur nuk zbatojnë detyrimet e nenit 15 të ligjit, që lidhen me pirjen e duhanit në mjedise të mbyllura, nga dy deri në gjashtë herë dhe pezullim të aktivitetit deri në pagimin e masës së gjobave.
- Parashikimin e një periudhe 48- mujore të hyrjes në fuqi të ndryshimeve të projektligjit, për paragrafin e parë, të dytë dhe të tretë të nenit 6 të projektligjit, i cili lidhet me ndalimin e vendosjes në treg të produkteve të duhanit me shije karakteristike dhe një periudhë 24-mujore të hyrjes në fuqi që lidhet me paketat që përmbajnë më pak se 20 cigare ose më pak se 30 gram neto produkt duhani.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi***

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe me legjislacionin përkatës që rregullon këtë fushë në vendet anëtare të BE-së.

Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin formal projektligji përbëhet nga 9 nene.

- ***Vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit me Acquis të BE-së***

Projektligji për afrohet pjesërisht me direktivën 2014/40/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e datës 3 prill 2014 “Mbi për afrimin e ligjit, rregullave dhe dispozitat administrative të shteteve anëtare rreth prodhimit, prezantimit dhe shitjes së duhanit dhe produkteve të duhanit dhe shfuqizimi i direktivës 2001/37/KE”.

Përputhshmëria me direktivën është e plotë për nenin 1 të përkufizimeve që ndryshohen dhe ato që shtohen. Gjithashtu edhe për nenin 2, pikat 4;5;6, nenin 6 paragrafi 1;2;3 dhe nenin 9.

Përputhshmëria është e pjesshme për nenin 3, i cili vendos detyrimin e prodhuesit për njoftimin e MSHMS, para hedhjes në treg të produkteve të reja të duhanit; për nenin 6 paragrafi 4;.

Nuk synon për afrim neni 7 dhe 8.

- ***Konsultimi publik***

Referuar relacionit që shoqëron projektligjin, rezulton se në zbatim të detyrimeve të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ky projektligj i është nënshtruar procesit të njoftimit dhe konsultimit publik nëpërmjet publikimit në regjistrin elektronik (RENJK).

Në respektim të parimit të transparencës dhe të gjithëpërfshirjes, mbi të cilat zhvillohet veprimtaria parlamentare, si dhe bazuar në përcaktimet e nenit 36 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni zhvilloi një séance dëgjimore me përfaqësues të subjekteve prodhuese, importuese/distributore dhe tregtuese të duhanit; përfaqësuesi i Japan Tobacco International (JTI), përfaqësues i Agna Grop, përfaqësues i Philip Morris International (PMI), përfaqësues i British American Tobacco (BAT), si dhe përfaqësuesi i OBSH në Shqipëri.

Përfaqësuesi i OBSH vlerësoi maksimalisht nismën e propozuar nga Këshilli i Ministrave. OBSH rekomandon trajtim të njëjtë nga ligji të produkteve të reja të duhanit me ato të duhanit tradicional, pasi bazuar në studimet shkencore, efekti që ato kanë në shëndet është i njëjtë. Po kështu, projektligji duhet të përmbajë edhe detyrimin e subjekteve prodhuese, importuese dhe distributore për të informuar MSHMS për hedhjen në treg të produkteve të reja të duhanit, përderisa kjo ministri është përgjegjëse për shëndetin publik.

Lidhur me ndikimin që ka ndalimi i pirjes së duhanit në mjedise të mbyllura, u shpreh se në vendet ku është aplikuar me ligj ky ndalim, si Spanja apo Franca, nuk ka rezultuar të ketë ulje të të ardhurave të bizneseve.

Përfaqësuesi i Philip Morris International vlerësoi projektligjin e propozuar dhe procesin e konsultimit publik të zhvilluar në të gjitha fazat e hartimit të tij. Problematika që ekziston në tregun e duhanit, sipas tij, qendron në funksionimin e tregut informal të shitjes së duhanit. Produktet e pakontrolluara që tregtohen në tregun informal janë ato që shkaktojnë dëme në shëndetin e konsumatorëve në një shkallë shumë më të lartë.

Edhe eksperti i pavarur i industrisë së duhan-cigareve argumentoi se ndërhyrja e qeverisë duhet të konsistojë në marrjen e masave për uljen e informalitetit të tregut të duhanit dhe jo thjesht në vendosjen e masave ndaluese apo shtrënguese ndaj bizneseve. Po kështu, edhe vendosja e akcizës mbi duhanin sjell thjesht deformim të tregut dhe rritje të informalitetit dhe nuk ndikon në uljen e përdorimit të tij.

Përfaqësuesi i HoReCa-s prezantoi dy propozime konkrete për riformulime në nenin 1 dhe 7 të projektligjit. U propozua që përkufizimi “pirje duhani” të mbetet ai që është në ligjin ekzistues. Ky propozim nuk u morr në konsideratë nga Komisioni pasi, referuar përfundimeve të studimeve shkencore që u prezantuan nga përfaqësuesi i OBSH, rezultoi se produktet e reja të duhanit kanë të njëjtin efekt negativ në shëndet si edhe duhani. Komisioni nuk pranoi as propozimin lidhur me reklamimin e produkteve të duhanit.

- ***Diskutimi në Komision***

Gjatë diskutimit të projektligjit në Komision, relatori e vlerësoi nismën dhe përgëzoi propozuesit dhe ekspertët për punën e bërë. Ai theksoi se duhanpirja është një fenomen social por me implikime të rëndësishme ekonomike dhe shëndetësore për shoqërinë që prek disa grupe në shoqëri, si qytetarët joduhanpirës, qytetarët duhanpirës, fëmijët dhe adoleshentët, bizneset që lidhen me tregtimin e produkteve të duhanit dhe qeverinë.

Projektligji vendos një sërë detyrimesh dhe ndaj prodhuesve, tregtuesve dhe importuesve në industrinë e duhani, që lidhen kryesisht me: detyrimin e tyre për të njoftuar ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, para hedhjes në treg të produkteve të reja të duhanit, përfshirë cigaret elektronike dhe duhanin me ngrohje; shtrirjen e ndalimit të konsumimit në mjediset ku ndalohet pirja e duhanit, edhe për cigaret elektronike, duhanin me ngrohje, shishave/nargjileve; ndalimin e vendosjes në treg të produkteve të duhanit me shije karakteristike; ndalimin i vendosjes në treg të produkteve të duhanit që përmbajnë aromatizues; kufizimin e numrit të cigareve që duhet të përmbajë një njësi pakete (jo më pak se 20 cigare); ndalimin e reklamimit të produkteve të duhanit, përfshirë promocionin indirekt përmes ngjyrave që përfaqësojnë logot e kompanive, ose promocionin nëpërmjet ekspozimit të produkteve që imitojnë paketimin e jashtëm të një produkti duhani. Të gjitha këto kufizime, pranohet se sjellin kosto financiare për tregtuesit e produkteve të duhanit, por ajo që prevalon në këtë rast është interesi i lartë publik, mbrojtja e shëndetit të popullatës.

Anëtarët e Komisionit e vlerësuan nismën e propozuar dhe kërkuar shpjegime nga propozuesit lidhur me nevojën e kryerjes së ndryshimeve dhe me procesin e konsultimit publik.

Lidhur me nevojën e kryerjes së ndryshimeve, përfaqësuesit e ministrisë, u shprehën se ligji për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit ka shërbyer si instrument kyç për kontrollin dhe rregullimin e produkteve të duhanit në vitet e fundit, duke dhënë rezultate pozitive, të cilat konkretizohen në trendin në rënie të prevalencës së duhanpirjes te meshkujt. Por, pavarësisht kësaj, shumë aspekte të duhanpirjes dhe risqeve të lidhura me këtë fenomen mbeten të pambuluara nga ligji në fuqi. Këto aspekte përfshijnë: mungesën e kuadrit rregullator për produktet e reja të duhanit që kanë hyrë në treg vitet e fundit; vijimin e bërjes së promocionit indirekt të produkteve të duhanit, pavarësisht se ligji nuk e lejon asnjë formë të promocionit të tyre; moszbatimin korrekt të masave ndëshkuese në rast të shkeljeve administrative që lidhen me produktet e duhanit.

Hartimi i këtyre ndryshimeve është paraprirë nga një analizë e situatës aktuale, nëpërmjet një vlerësimi të zbatimit të tij në të gjitha nivelet, pika të shitjes së produkteve të duhanit, mjedise publike, procesin e inspektimit nga ISSH-ja, nëpërmjet organizimit të vizitave vlerësuese nëpër rrethe, me pjesëmarrje të ekipeve të përbashkëta të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Institutit të Shëndetit Publik dhe Institutit të Sigurimeve Shëndetësore

Procesi i Konsultimit publik ka qenë i vazhdueshëm dhe gjithëpërfshirës. Projektligji u është dërguar të gjithë grupeve të interesit dhe u është dhënë mundësia për të bërë edhe komentet e sugjerimet e tyre, të cilat pjesërisht janë marrë në konsideratë.

Deputetët kërkuar informacion të hollësishëm mbi nivelin e zbatimit të ligjit në institucionet publike, statistika mbi trendin e duhanpirjes tek meshkujt dhe femrat, përqindjen e popullsisë që konsumon duhan. Ky informacion do të vendoset në dispozicion të anëtarëve të Komisionit nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor.

- ***Ndryshime të projektaktit***

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni, me unanimitet, e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për votim në seancë plenare.

Gjatë shqyrtimit nen për nen, Komisioni miratoi vërejtjet si më poshtë vijon:

1. **Në nenin 8 të projektligjit,** në paragrafin e dytë, në fund të fjalisë, të hiqet shprehja “*dhe pezullim të aktivitetit deri në shlyerjen e masave të gjobës.*”

RELATOR

Andrea MARTO

KRYETAR

Niko PELESHI